



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 1357/1 prot.

Vlorë, më 26.01 2024

Lënda: Mbi percjelljen e Projekt-Vendimeve “Për një ndryshim në vendimin nr.96, datë 07.12.2023 i Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024” si dhe Projekt- Vendimin “Për miratimin e taveve përgatitore për të ardhurat 2025-2027”.

KËSHILLIT BASHKIAK VLORË

Z.Daut Zeraj, Sekretar i Këshillit

Bashkëlidhur kësaj shkrese, po ju përcjellim për te parashikuar në rend dite në mbledhjen e datës 29.01.2024 Projekt Vendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.96, datë 07.12.2023 i Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024” si edhe relacionin shpjegues për shkak të rëndësisë që përmban në vetvete duke përcaktuar tarifat e reja për shërbimet funerale, si dhe Projekt-Vendimin “Për miratimin e taveve përgatitore për të ardhurat 2025-2027”

Duke ju falenderuar per mirëkuptimin!

DREJTOR JURIDIK

Dorian Demiri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1357 prot.

Vlorë, më 26.01 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë, _____ 2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.96, DATË 07.12.2023 I KËSHILLIT TË
BASHKISË VLORË
“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NE TERRITORIN E
BASHKISË VLORË PËR VITIN 2024”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, neni 9, pika 1, nën pika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 29, pikat 3 dhe 4, nenin 54, shkronja “k” dhe nenin 55, pikat 2 dhe 6, në Ligjin nr.68/2017” Për Financat e Vetëqeverisjes vendore”, në Ligjin nr. 9220 datë 15.04.2004 “Për Administrimin e shërbimit të varrimit” Nenin 3 pika dh, në Urdhërin e brendshëm nr.16 datë 12.01.2024 me nr.490 prot, datë 12.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, në situacionin nr.78 Prot, datë 23.01.2024,

VENDOSI:

1. Në Kreun VIII, pika f te Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të VKB-së nr.96, datë 07.12.2023 “Për Miratimin e Taksave dhe Tarifave vendore në Territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024 ” të shtohet zëri me këtë përmbajtje te Ndërmarrja e Shërbimeve Publike :

Tarifa shërbimi për shpenzime funerale

f / 7 - Tarifë shërbimi për varrimin në vlerën 21670 lekë.

f / 8 - Tarifë shërbimi për zhvarrimin në vlerën 216124 lekë.

2. Per zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë, bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

Konceptoi: *S.Kalemi*

Miratoi: *D.Demiri*

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1357 prot.

Vlorë, më 26.01 2024

RELACION

Mbi Projekt-Vendimin “Për një ndryshim në Vendimin nr.96, datë 07.12.2023 i Këshillit të Bashkisë Vlorë
“Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024”

PARA KËSHILLIT TË BASHKISË

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt -Vendimi që ju paraqesim për miratim është një detyrim ligjor që rrjedh nga Ligji , nr. 9220 datë 15.04.2004 “Për Administrimin e shërbimit të varrimit” Nenin 3/dh pika 2 *Tarifat* nëpërmjet të cilave ligjvënësi ka përcaktuar detyrimin se Tarifat e shërbimit për varrezat publike do të miratohen nga Këshilli i Njësisë bazë përkatëse të Qeverisjes Vendore.

Në Vendimin nr.96, datë 07.12.2023 i Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024” nuk ishin parashikuar tarifat për varrimin dhe zhvarrimin pasi administrimi i shërbimit funeral kryhej nga një subjekt privat.

Ndodhur ne këto kushte, me Urdhër te Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Vlorë “Për marrjen në dorëzim të dokumentacionit nga Shoqëria K.N sh.p.k si edhe pergatitjen e strukturës së nevojshme për menaxhimin e shërbimit publik të varrimit nga Drejtoria e Ndërrmarjes së Shërbimeve publike, është ngritur grupi i punës me qëllim kryerjen e një analize të detajuar lidhur me proceduren e shërbimit per varrimin publik.

Grupi i punës në një nga detyrat e percaktuara ka patur si detyrim ligjor kryerjen e analizës dhe koston reale te sherbimeve funerale. Ne lidhje me përlogaritjen e tarifave te shërbimit për shpenzimet funerale grupi i punës është bazuar në cmimet e parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.216 datë 13.04.2023 duke aritur në përfundimin e vlerave si më poshtë:

Tarifa shërbimi për varrimin në vlerën 21.670 lekë
Tarifë shërbimi për zhvarrimin në vlerën 16.124 lekë.


Bashkelidhur këtij projekt vendimi po ju vendosim analizën e kostos në mënyrë te detajuar per të dy tarifat e shërbimit funeral.

Në këto kushte, kërkojmë prej jush miratimin e këtij Projekt-Vendimi duke vlerësuar në një vendimmarje positive në shërbim të komunitetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi: *S.Kalemi*

Miratoi: *D.Demiri*



KRYETAR

Ermal Dredha



NR	NA	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLEFTA
1	2.1	Germim dheu me krah e transport k dore 10m, kat III	m3	5.25	1368.65	7,185
2	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 t=5cm (Pllakat anesore)	m3	0.36	14190.56	5,109
3	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 t=5cm (Pllakat e mbulimit)	m3	0.13	14190.56	1,845
4	Anal.	Puntori (5 veta)	op	40	125	5,000
		Shpenzime operative dhe kapitale te tjera				2,531
		SHUMA	LEKE			21,670

NR	NA	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLEFTA
1	2.1	Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III	m3	2.625	1368.65	3,593
4	Anal.	Puntori (5 veta) operative dhe kapitale	op	80	125	10,000
		SHUMA	LEKE			2,531
						16,124